

NYC Health + Hospitals Options

PERSONELI PËR T'U KONTAKTUAR PËR NDIHMË

BRONX

NYC Health + Hospitals/Lincoln 718-579-6414

NYC Health + Hospitals/Morrisania 718-960-2214

NYC Health + Hospitals/Belvis 718-579-1763

NYC Health + Hospitals/Jacobi 718-918-3375

NYC Health + Hospitals/North Central Bronx 718-918-3375

BROOKLYN

NYC Health + Hospitals/Woodhull 718-630-3020

NYC Health + Hospitals/Cumberland 718-260-7742

NYC Health + Hospitals/Kings County 718-245-1323

NYC Health + Hospitals/East New York 718-240-0630

NYC Health + Hospitals/Coney Island 718-616-5024

MANHATTAN

NYC Health + Hospitals/Harlem 212-939-8125

NYC Health + Hospitals/Renaissance 212-932-6504

NYC Health + Hospitals/Metropolitan 212-423-7990

NYC Health + Hospitals/Bellevue 212-562-6264

NYC Health + Hospitals/Gouverneur 212-238-7139

QUEENS

NYC Health + Hospitals/Elmhurst 718-334-2565

NYC Health + Hospitals/Queens 718-883-2545

STATEN ISLAND

NYC Health + Hospitals/Mariner's Harbor 844-NYC-4NYC

NYC Health + Hospitals/Vanderbilt 844-NYC-4NYC

Jeto jetën tënde më të shëndetshme.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



JINI TË LIDHUR. NA NDIQNI.

BËRJA E KUJDESIT SHËNDETËSOR CILËSOR TË PËRBALLUESHËM

NYC Health + Hospitals Options

Jeto jetën tënde më të shëndetshme.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



Nuk keni sigurim shëndetësor? Mos u shqetësoni mund t’ju ndihmojmë.

Keni të drejtë për një kujdes shëndetësor të cilësisë së lartë. Mënyra më e mirë për t’a bërë të përballueshëm nga ana ekonomike një kujdes të tillë është të regjistroheni për sigurim shëndetësor. Mund t’ju ndihmojmë për t’ju shpjeguar zgjedhjet dhe për t’ju ndihmuar të regjistroheni në një plan që ju përshtatet më së miri juve dhe familjes suaj. Nëse nuk kualifikoheni ose nëse nuk i përballoni dot planet e sigurimit shëndetësor të ofruara pa pagesë ose me kosto të ulët mund të kualifikoheni për **NYC Health + Hospitals Options** – një plan pa pagesë ose me ulje çmimi për t’jua bërë të mundur shërbimet tona të kujdesit shëndetësor juve dhe familjes suaj.

SI MUND TË MËSOJ RRETH MUNDËSIVE TË OFRUARA?

Fillimisht flisni me një prej konsulentëve financiarë të NYC Health + Hospitals që mund t’ju ndihmojë juve dhe familjen tuaj të regjistroheni në sigurimin shëndetësor pa pagesë ose me kosto të ulët nëse kenë të drejtë t’a përfitonin. Konsulentët tanë financiarë janë të gatshëm t’ju ndihmojnë të zgjidhni nga një larmi planesh sigurimi shëndetësor ku mund të keni të drejtë të përfitonin. Nëse nuk keni të drejtë të përfitonin asnjë plan sigurimi shëndetësor nuk përballoni dot mbulimin e sigurimit ose nuk keni mundësi financiare për të paguar për kujdesin shëndetësor mund të përfitonin tarifa të ulëta dhe të përballueshme mjekësore përmes programit NYC Health + Hospitals Options.

Options ofrohet për personat që banojnë apo vizitojnë qytetin e Nju Jorkut. Ndihojmë personat që banojnë apo vizitojnë kontenë e Nasaut dhe përdorin spitalet e qendrat tona shëndetësore në Kuins. Ndihojmë gjithashtu personat që banojnë apo vizitojnë kontenë e Uestçesterit dhe përdorin spitalet e qendrat tona shëndetësore në Bronks.

PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM SIGURIMI SHËNDETËSOR?

Askujt nuk i pëlqen të lëndohet apo të sëmuret; por situata të papritura mjekësore mund të ndodhin. Kur keni një plan sigurimi shëndetësor ju ndihmon të paguani për një pjesë të kostove të tilla të papritura duke përfshirë dhe barnat me receta e faturat e rregullta e të larta mjekësore si dhe ju jep qetësi. E dimë gjithashtu se personat me sigurim shëndetësor kanë më shumë gjasë të përfitojnë kujdesin parandalues që kanë nevojë ata vetë dhe familja e tyre për të qëndruar të shëndetshëm.

NYC Health + Hospitals ofron kujdes shëndetësor për të gjithë. Respektojmë të drejtat dhe konfidencialitetin e të gjithë pacientëve duke përfshirë dhe personat që nuk kanë dokumentacion të rregullt. I ndihmojmë ata që nuk flasin anglisht që të bisedojnë me doktorët dhe me anëtarët e tjerë të personelit. Personeli ynë flet shumë gjuhë mes të cilave shqip arabisht gjuha bengale gjuha kineze frëngjisht kreole haitiane gjuha indiane gjuha koreane polonisht rusisht spanjisht dhe gjuha urdu. Ofrohen gjithashtu edhe shërbime përkthimi me gojë. Mund të merrni informacion në gjuhën tuaj.

ÇFARË MË DUHET PËR TË APLIKUAR PËR SIGURIM APO PËR OPTIONS?

Do t’ju kërkohet nga një punonjës i NYC Health + Hospitals që të jepni informacion rreth nivelit të të ardhurave tuaja dhe madhësisë së familjes. Fillimisht do t’ju ndihmojmë të aplikoni për planet e sigurimit shëndetësor publik dhe për Qualified Health Plans – Medicaid Essential Plan Child Health Plus EPIC (për të moshuarit) dhe ADAP (për personat me HIV/ AIDS). Ky është një aplikim i sigurtë dhe asnjë informacion nuk u jepet funksionarëve të zyrës së emigracionit.

SA DUHET TË PAGUAJ?

Ofrohen shumë plane sigurimi shëndetësor me kosto të ulët ose pa pagesë. Mund t’i diskutojmë së bashku mundësitë e zgjedhjes. Nëse nuk mund të përballoni mbulimin e sigurimit shëndetësor atëherë do të paguani aq sa mund të përballoni. Grafiku në faqen vijuese tregon se sa mund t’ju kërkohet të paguani në programin Options. Tarifa për ju mund të jetë e ulët deri në 0 dollarë për një vizitë te doktori.

PO SIKUR TË MARR FATURË NDËRSA JAM DUKE PRITUR TË MËSOJ RRETH MBULIMIT TË SIGURIMIT TIM SHËNDETËSOR?

Nëse keni aplikuar për sigurim shëndetësor nuk do t’ju kërkohet t’a paguani faturën gjatë kohës që po ju shqyrtohet aplikimi. Nëse merrni një faturë duhet të kontaktoni me spitalin ose qendrën shëndetësore dhe të kërkonti të flisni me konsulentin financiar që do t’ju ndihmojë.

SI TË APLIKOJ PËR SIGURIM SHËNDETËSOR OSE PËR OPTIONS?

Telefonojini cilësdoo prej qendrave tona të kujdesit shëndetësor në faqen e pasme të kësaj broshure.

HAPI 1:

Përcaktoni madhësinë e familjes (përfshini të gjithë të rriturit dhe fëmijët që banojnë me ju).

HAPI 2:

Në vijim përcaktoni shumën që paguheni në një vit në njërin prej niveleve.

HAPI 3:

Ndiqui kolonën deri në fund të grafikut për të mësuar se sa do të paguani në përputhje me madhësinë e familjes dhe të ardhurat tuaja për vizitat mjekësore vizitat në urgjencë dhe shtrimet spitalore.

ANNUAL INCOME	<100%	101-125%		126-150%		151-200%		201-250%		251-300%		301-350%		351-400%		401% +
HOUSEHOLD SIZE	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se
1	12 490 USD	12 491 USD	15 613 USD	15 614 USD	18 735 USD	18 736 USD	24 980 USD	24 981 USD	31 225 USD	31 226 USD	37 470 USD	37 471 USD	43 715 USD	43 716 USD	49 960 USD	49 961 USD
2	16 910 USD	16 911 USD	21 138 USD	21 139 USD	25 365 USD	25 366 USD	33 820 USD	33 821 USD	42 275 USD	42 276 USD	50 730 USD	50 731 USD	59 185 USD	59 186 USD	67 640 USD	67 641 USD
3	21 330 USD	21 331 USD	26 663 USD	26 664 USD	31 995 USD	31 996 USD	42 660 USD	42 661 USD	53 325 USD	53 326 USD	63 990 USD	63 991 USD	74 655 USD	74 656 USD	85 320 USD	85 321 USD
4	25 750 USD	25 751 USD	32 188 USD	32 189 USD	38 625 USD	38 626 USD	51 500 USD	51 501 USD	64 375 USD	64 376 USD	77 250 USD	77 251 USD	90 125 USD	90 126 USD	103 000 USD	103 001 USD
5	30 170 USD	30 171 USD	37 713 USD	37 714 USD	45 255 USD	45 256 USD	60 340 USD	60 341 USD	75 425 USD	75 426 USD	90 510 USD	90 511 USD	105 595 USD	105 596 USD	120 680 USD	120 681 USD
6	34 590 USD	34 591 USD	43 238 USD	43 239 USD	51 885 USD	51 886 USD	69 180 USD	69 181 USD	86 475 USD	86 476 USD	103 770 USD	103 771 USD	121 065 USD	121 066 USD	138 360 USD	138 361 USD
7	39 010 USD	39 011 USD	48 763 USD	48 764 USD	58 515 USD	58 516 USD	78 020 USD	78 021 USD	97 525 USD	97 526 USD	117 030 USD	117 031 USD	136 535 USD	136 536 USD	156 040 USD	156 041 USD
Vizitë në klinikë për të rritur	\$0	\$2		\$3		\$20		\$30		\$40		\$50		\$50		Tarifime të plota
Vizitë në klinikë për fëmijë ose grua shtatzënë	\$0	\$0		\$0		\$20		\$30		\$40		\$50		\$50		Tarifime të plota
Vizitë në klinikë të shëndetit mendor	\$0	\$0		\$0		\$15		\$30		\$40		\$50		\$50		Tarifime të plota
Vizitë në sallën e urgjencës për të rritur	\$0	\$3		\$3		\$75		\$80		\$100		\$120		\$120		Tarifime të plota
Vizitë në sallën e urgjencës për fëmijë ose grua shtatzënë	\$0	\$0		\$0		\$75		\$80		\$100		\$120		\$120		Tarifime të plota
Pacienti bashkëpaguan dhe i zbriten	\$0	\$0		\$0		\$0		\$10		\$12		\$18		\$22		Bashkëpagesë e plotë dhe zbritje
Barna me receta (tarifa për bar*)	\$2	\$2		\$2		\$6		\$10		\$14		\$18		\$18		Kostoja aktuale plus 6 USD
Operacion kirurgjik ambulator ose skanim MRI	\$0	\$15		\$25		\$150		\$300		\$450		\$550		\$650		Tarifime të plota
Shtrimi i pacienti të brendshëm në spital**	\$0	\$25		\$25		\$150		\$400		\$900		\$1 500		\$1 500		Medicaid DRG

* do të ulet edhe më tej nëse tarifa është më e lartë se kostoja e barnave apo shërbimet
** Kursimet përtej 8 000 USD do të tarifohen me 2% më shumë

4/1/2019